



KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 5.2.2019

Dokument parlamentar

RAPORT PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.124/2015, “PËR EFIÇENCËN E ENERGJISË””

- ***Hyrje***

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, bazuar në nenet 32 - 38 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, shqyrtoi projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.124/2015, “Për eficiency e energjisë””, në mbledhjet e tij të datës 29 janar dhe 5 shkurt 2019.

Komisioni caktoi relator për këtë projektligj Zotin Arben Pëllumbi.

Të pranishëm gjatë shqyrtimit të projektligjit ishin përfaqësues të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe përfaqësues të Agjencisë për Eficiency e Energjisë.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.124/2015, “Për eficiency e energjisë”” është nismë e Këshillit të Ministrave dhe i paraqitet për shqyrtim Kuvendit mbështetur në nenet 78, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 1 e Rregullores së Kuvendit.

- ***Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektligjit***

Projektligji është një nga projektligjet e propozuar si pjesë e reformës së deregulimit e cila ka si qëllim krijimin e lehtësirave të mëtejshme për përmirësimin e klimës së biznesit, nëpërmjet reduktimit të barrierave administrative.

Projektligji synon që ushtrimi i veprimtarisë së auditimit të energjisë dhe shërbimet energjetike të jenë të lira. Për të mundësuar këtë, propozohet shfuqizimi i licencës “*Auditues energjetik*” dhe i licencës “*Shërbime energjetike*”, të cilat janë parashikuar si licenca në ligj, pavarësisht se ende nuk janë përfshirë në njërën prej kategorive dhe nënkategorive të përcaktuara në aneksin 1, të vendimit nr.538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga ose nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit”, të ndryshuar.

Konkretisht projektligji parashikon që veprimtaria e auditimit të energjisë dhe veprimtaria e shërbimeve energjetike të kryhen nga subjekte të certifikuara për këtë qëllim.

Certifikohen për kryerjen e veprimtarisë së auditimit energjetik personat fizikë të regjistruar si të tillë, që kanë aftësi teknike dhe përvojën e nevojshme për kryerjen e këtyre veprimtarive. Kjo veprimtari mund të kryhet dhe nga persona juridikë, të cilët kanë të punësuar auditues energjetikë të certifikuar. Si personat fizikë edhe personat juridik që kryejnë këtë veprimtari, duhet të kenë të regjistruar në regjistrin tregtar, si objekt veprimtarie, kryerjen e kësaj veprimtarie.

Shërbimet energjetike, sipas ligjit, sigurohen nga shoqëri të specializuara për shërbimet energjetike. Projektligji parashikon që shërbimet energjetike mund të ofrohen nga subjekte, persona juridikë, që kanë të regjistruar në regjistrin tregtar, si objekt veprimtarie, kryerjen e kësaj veprimtarie.

Procedura, kategoritë, kushtet, kërkesat e kualifikimit dhe të eksperiencës profesionale për personin, të cilit i lëshohet certifikata e audituesit energjetik dhe ofruesve të shërbimeve energjetike, do të miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Gjithashtu, projektligji përcakton edhe detyrimin e Agjencisë për Eficiência e Energjisë për të mbajtur, përditësuar dhe publikuar në faqen e saj zyrtare të internetit një listë të audituesve energjetikë dhe të ofruesve të shërbimeve elektrike.

- ***Vlerësimi i Ligjshmërisë Kushtetuese dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi dhe aktet ndërkombëtare.***

Projektligji është në përputhje me nenet 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

Në aspektin procedural projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në aspektin formal projektligji përbëhet nga 5 nene.

- ***Vlerësimi i përputhshmërisë së projektligjit me Acquis Communautaire***

Projektligji nuk përafron e nuk lidhet me asnjë *acquis* të Bashkimit Evropian.

- ***Efektet financiare të projektligjit***

Ky projektligj nuk ka efekte financiare në buxhetin e shtetit.

- ***Diskutimi në komision***

Relatori i projektligjit u shpreh që projektligji në thelb synon thjeshtimin e procedurave për ushtrimin e veprimtarisë së audituesit energjetik dhe shërbimeve energjetike në fushën e efikasitetit të energjisë, duke krijuar lehtësira për biznesin.

Përfaqësuesit e Ministrisë sqaruan që ky projektligj është propozuar në kuadër të reformës deregulluese për lehtësimin e lejeve, licencave dhe autorizimeve. Projektligji propozon shfuqizimin e licencës për audituesin energjetik dhe licencës për shërbimet energjetike.

Gjatë diskutimeve në Komision, deputetët shprehën shqetësime në lidhje me kriteret që do të përcaktohen për certifikimin e audituesve energjetikë, kryesisht për arsimin të tyre, duke sugjeruar që të përcaktohet në VKM-në që do dalë në zbatim të kësaj çështjeje, që të jinteresuarit të kenë formim inxhinieri. Përsa i përket kryerjes së kësaj veprimtarie, u diskutua edhe mundësia që kjo veprimtari të mos kryhej nga një person i vetëm por nga një grup inxhinierësh me profile të ndryshme. Gjithashtu, u diskutua edhe për mundësinë që, përsa i takon profesorëve dhe profesorëve të asociuar të cilët janë lektorë në kurset pasuniversitare që do të ndiqen nga personat e interesuar për t'u bërë auditues energjetikë apo të shërbimeve energjetike, të pajisen automatikisht me këtë certifikatë, pa qenë nevoja për kryerjen e këtij kursi.

Një tjetër çështje për të cilën u diskutua lidhet me faktin se kush do t'i certifikojë subjektet e interesuar për ushtrimin e veprimtarisë së audituesit energjetik dhe të ofruesit të shërbimeve energjetike. Në përfundim të diskutimeve Komisioni vendosi që certifikimin ta bëjë Agjencia për Efikasitetin e Energjisë. Kësaj Agjencie iu la edhe kompetenca për revokimin e këtyre certifikatave.

Në përgjigje të shqetësimeve të deputetëve, përfaqësuesit e Ministrisë sqaruan se personat që do të certifikohen për veprimtarinë e audituesit energjetik dhe të shërbimeve energjetike do të jenë me formim inxhinierë të të gjitha profesioneve dhe kërkohet një eksperiencë minimale, si dhe një kurs trajnimi pasuniversitar i kryer për këtë fushë, duke qenë se është një degë e re dhe një fushë e re. Më pas, do të bëhet testimi pranë Agjencisë për Efikasitetin e Energjisë.

- ***Ndryshime të projektligjit***

Gjatë shqyrtimit nen për nen, Komisioni vendosi që në tekstin e projektligjit të bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. **Në nenin 1**, përkufizimi i pikës 2 të riformulohet si më poshtë:

“2. Auditues energjetik” është një person fizik i certifikuar ose person juridik që ka të punësuar auditues energjie të certifikuar, i cili kryen auditime energjetike në përputhje me përcaktimet e këtij ligji.”.

2. **Në nenin 3** të bëhen ndryshimet si më poshtë:

- a) Pika 1 të riformulohet si vijon: “1. Audituesi energjetik për kryerjen e veprimtarisë së auditimit energjetik pajiset me certifikatë nga Agjencia për Efiçencën e Energjisë, e cila mban, përditëson dhe publikon në faqen e saj zyrtare një listë të audituesve energjetikë.”;
- b) Në pikën 2 pas fjalës “miraton” të shtohet fjala “procedurën”;
- c) Pika 4 të hiqet;
- d) Në pikën 8, në fjalinë hyrëse, fjala “Ministri” të zëvendësohet me fjalët “Agjencia për Efiçencën e Energjisë”; **dhe** fjalët “vendos ndërprerjen e ushtrimit të këtij aktiviteti nga audituesi energjetik përkatës, në rast se:” të zëvendësohet me fjalët “vendos revokimin e certifikatës të audituesit energjetik në rast se:”;
- e) Në pikën 9 fjala “Ministri” të zëvendësohet me fjalët “Agjencia për Efiçencën e Energjisë”;
- f) Pika 10 të riformulohet si vijon: “10. Një auditues energjetik, të cilit i është revokuar certifikata sipas pikës 8 të këtij neni, ka të drejtë të aplikojë për certifikatë të re jo më herët se tre vjet nga data e marrjes së vendimit të mësipërm. Në rast se të njëjtit person i revokohet certifikata për herë të dytë, atëherë ky person nuk ka më të drejtë të aplikojë për certifikatë.”.

3. **Në nenin 4** të bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

- a) Në pikën 2 fjalët “ofrohen nga subjekte, që” të zëvendësohen me fjalët “ofrohen nga persona juridikë që certifikohen nga Agjencia për Efiçencën e Energjisë dhe”;
- b) Pas pikës 2 të shtohet pika 2/1 me përmbajtje si vijon: “Në pikën 3, pas fjalës “miraton” të shtohet fjala “procedurën”;
- c) Pika 7 të hiqet.

- ***Përfundim***

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni vlerësoi projektligjin për kontributin që do të ketë në krijimin e lehtësirave për ushtrimin e veprimtarisë së audituesit energjetik dhe shërbimeve energjetike pa qenë nevojë për t'u licencuar.

Komisioni e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi me të gjitha votat e anëtarëve të pranishëm dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

Arben PËLLUMBI

Niko PELESHI

Relator

Kryetar